# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437911**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | AfD ngre padi penale kundër Merz për deklaratën e tij mbi planin për spastrim etnik - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/afd-ngre-padi-penale-kunder-merz-per-deklaraten-e-tij-mbi-planin-per-spastrim-etnik/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 08:05:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 08:05:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `73926a3073ffd34df2049e5e7f066d9a7bcee49b46f2b0090b75093a05b1a087` |
| TEKSTI | `92bc2746d7183277e36c5da249032d1633c797848ecfd4a6ecff3999f37d5ab4` |
| PAMJA | `78be949cc985ffe03a52ae0dec362c4962ce4389b194ce45666fbdaee9becf26` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ed95a4fab3c4798637f120199b32e3303527a39ebf560a1fa1832d6881e175be` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a37a19bd8769ebad3f30fd8502903a3868a0ddc6c817d6dbe0c66d76bad4893c` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ed95a4fab3c4798637f120199b32e3303527a39ebf560a1fa1832d6881e175be`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EVROPA

# AfD ngre padi penale kundër Merz për deklaratën e tij mbi planin për spastrim etnik

12 Shtator 2026 | 10:05

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Partia e krahut të djathtë Alternativa për Gjermaninë (AfD) ngriti padi penale kundër kancelarit gjerman Friedrich Merz për deklaratën e tij se planet e partisë për "emigrim" përbënin "spastrim etnik".

Deputeti i AfD-së, Stefan Brandner, vlerësoi se deklarata e Merz kaloi kufirin dhe kërkoi që gjyqësori gjerman të reagojë.

"Insinuata se grupi parlamentar i AfD-së, i cili qëndron fort mbi themelet e kushtetutës gjermane, mbështet spastrimin etnik, pra në fund të fundit dëbimet dhe vrasjet, është aq e qartë saqë gjyqësori duhet të reagojë", tha Brandner.

Gjatë një debati në Bundestag të mërkurën, Mertz tha se "remigrimi" është thjesht një emër tjetër për "spastrimin etnik bazuar në origjinë dhe ngjyrën e lëkurës", raporton portali i Brukselit Politiko.

Në të njëjtën kohë, ai paralajmëroi se politika e rreptë e migracionit e AfD-së do të shkaktonte dëme të mëdha në ekonominë gjermane.

Sipas nenit 46 të Kushtetutës Gjermane, anëtarët e Bundestagut në përgjithësi gëzojnë mbrojtje nga veprimet ligjore për deklaratat e bëra në parlament.

Megjithatë, kjo mbrojtje nuk zbatohet në rastin e "fyerjeve shpifëse", të cilave AfD u referohet në kërkesën e saj.

Termi "rimigrim" përdoret nga AfD për t'iu referuar kthimit ose deportimit të migrantëve që partia i konsideron se nuk kanë të drejtë të qëndrojnë në Gjermani. Ky koncept mund të përfshijë deportimin e personave pa status ligjor, por edhe plane më të gjera për emigrimin e migrantëve dhe pasardhësve të tyre.

Mertz deri më tani nuk ka komentuar mbi kërkesën e AfD-së, ndërsa zyra e tij e shtypit nuk iu përgjigj menjëherë një kërkese për koment.

Në programin e saj zgjedhor për shtetin e Saksonisë-Anhalt, AfD i kushtoi një kapitull të veçantë çështjeve të "imigracionit dhe riemigrimit". Kjo parti fitoi bindshëm zgjedhjet në atë provincë të dielën.

LAJMI I FUNDIT

09:59 **Shpërthim me lëndë plasëse në portën e një banese në Bathore, detajet e para**

09:17 **Putin: Gabimet e Perëndimit çuan në ngritjen e AfD-së**

09:10 **Treni del nga shinat në Francë, të paktën 44 të plagosur**

09:05 **Tentativë e pabesueshme kontrabande në Majorka, 109 pako kokainë gjenden në trupin e pasagjerit**

08:41 **Edi Rama rikthehet në Vlorë, reforma territoriale në fokus të takimit me qytetarët**

08:37 **Arratisje si në filma e të burgosurit shqiptar në Greqi, bashkëpunëtorët bllokojnë eskortën me kallashnikovë**



**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

EVROPA

### Treni del nga shinat në Francë, të paktën 44 të plagosur

Të paktën 44 persona u plagosën, përfshirë një në gjendje të rëndë, pasi një tren pasagjerësh doli nga shinat në Francën veriore, thanë autoritetet lokale....

09:10 | 12/09/2026

EVROPA

### Tentativë e pabesueshme kontrabande në Majorka, 109 pako kokainë gjenden në trupin e pasagjerit

Policia spanjolle arrestoi një burrë në trupin e të cilit u gjetën 109 pako kokainë, me një peshë totale bruto prej rreth 1,353 gramësh, gjatë...

09:05 | 12/09/2026

EVROPA

### Ligjvënësit e Mbretërisë së Bashkuar hedhin poshtë projektligjin për eutanazinë për Anglinë dhe Uellsin

Ligjvënësit e Mbretërisë së Bashkuar hodhën poshtë të premten legjislacionin që do t'u lejonte të rriturve me sëmundje terminale në Angli dhe Uells të zgjidhnin...

18:29 | 11/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.